

VENDIM
Nr. 487, datë 30.7.2021

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 397, DATË 13.5.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT ‘UNAZA LINDORE TIRANË, LOTI
3”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 397, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truell”, me sipërfaqe 1909 (një mijë e nëntëqind e nëntë) m², me vlerë 62 764 102 (gjashtëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e dy) lekë.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Vlera shtesë prej 62 764 102 (gjashtëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e dy) lekësh të përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.”.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.”.

4. Pika 12 riformulohet, si më poshtë vijon:

“12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1 dhe Tiranë Jug, si dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE PËR PASURINË E PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 397, DATË 13.5.2020, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT NDËRTIMI I OBJEKTIT UNAZA LINDORE TIRANË, LOTI 3”

LINDORE TRUALL, LOTI 5																									
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. tot. (m²)	ARË			TRUALL			BANESË			Sip. m²	Çmimi	Vlera	NDËRTESE	Sip. m²	Çmimi	Vlera	Vlera totale, lek	SHËNIME
								Sip. m²	Çmimi 1/m²	Vlera, lek	Sip. m²	Çmimi 1/m²	Vlera, lek	Sip. m²	Çmimi 1/m²	Vlera lek									
1	REZART RAMAZAN KUPTHI			8170	9/705	TRUALL	1909				1909	32878	62,764,102.00										62,764,102.00	Seksioni D: Mbi këtë truall pozicionohen ndërtesat me nr. 9/612/nd., vol 24, f. 41, hip 1266/93 ksh, mbi këtë truall ka ndërtime pa leje.	
Mbyllet me nr. rendor 1																							TOTALI	62,764,102.00	